



## PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2011

I DETYRUAR

### SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT

**VARIANTI A**

**Lënda: Letërsi dhe Gjuhë shqipe**

**Shkollat e mesme të gjuhëve të huaja  
(kurrikula e vjetër)**

*Udhëzime të përgjithshme:*

- Testi përbëhet nga dy pjesë.
- Testi përmban një total prej 50 pikësh.
- Testi ka 25 pyetje. 13 me zgjedhje dhe 12 me zhvillim.
- Për pyetjet me zgjedhje përgjigja e saktë vlerësohet me 1 pikë.
- Për pyetjet me zhvillim përgjigjet konsiderohen orientuese dhe në skemë parashikohen variantet e mundësive të përgjigjeve të nxënësve.
- Vlerësimi i pyetjes *ese* do të bëhet duke pasur parasysh rubrikat në tabelën e vendosur në fund të pyetjes dhe që është posaçërisht për vlerësuesit e testit.
- Saktësia gjuhësore ndikon negativisht në vlerësimin e nxënësit, në ato raste, kur ka përsëritje të theksuar gabimesh ose gabime të cilat prishin në mënyrë të vazhdueshme kuptimin e shprehjes.

**PJESA I****Eposi i kreshnikëve*****Martesa e Halilit (fragment)***

Pyetja 1	C	1 pikë
Pyetja 2	C	1 pikë
Pyetja 3	C	1 pikë
Pyetja 4	B	1 pikë
Pyetja 5	C	1 pikë
Pyetja 6	B	1 pikë
Pyetja 7	B	1 pikë

**Pyetja 8**                      **4 pikë****Model përgjigjeje**

- Midis dhe kreshnikëve ekzistojnë marrëdhënie të singerta, miqësore, të hapura, ndihme. Trimat nuk janë të nënshtruar përpara prijësit të tyre. Të tërë shqetësohen për nderin e përbashkët, sepse janë pjesëtarë të një fisi.

**2 pikë**                      **Marrëdhëniet që ekzistojnë:** nëse nxënësi shkruan në mënyrë të plotë thelbin e këtyre marrëdhënieve.

**DHE**

**1 pikë**                      Nëse jep në mënyrë të pjesshme natyrën e marrëdhënieve midis Mujit dhe kreshnikëve:

- Marrëdhënie miqësore;
- Marrëdhënie ndihme;
- Janë të singertë me njëri-tjetrin;
- Nuk i druhen prijësit të tyre;
- Etj.

**2 pikë**                      **Ilustrimet:** nëse jep dy ilustrime që lidhen me kërkesën e pyetjes.

- Tutna djalit dikush po na e rre
- Le konakun, Mujë, po ta fikin,
- po na koritin
- Faqebardhë, more shokë, ju qofsha
- Sa mirë hallin po ma ditki burra...

**DHE**

**1 pikë**                      Nëse jep vetëm një ilustrim që lidhet me kërkesën e pyetjes

**0 pikë**                      Nëse përgjigja e dhënë nuk i përmbahet thelbit të pyetjes ose nuk ka përgjigje.

*Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, shpreh mendime dhe ide që nuk i përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit i gjykon të sakta.*

**Pyetja 9**                      **1 pikë****Model përgjigjeje:**

Halili nuk pranon të martohet me asnjë nga vajzat e krahinës, sepse:

- ato i duken si motra OSE  
 ➤ ka rënë në dashuri me një vajzë të huaj.

**1 pikë**                      Nëse përmend **një** prej rasteve të dhëna më sipër.

**0 pikë**                      Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 10**                      **4 pikë****Model përgjigjeje**

- Është një bukuri në lëvizje, plot jetë, në zhvillim e sipër. Rapsodi ka nxjerrë në pah detaje (i ka theksuar) që japin përfytyrimin e lëvizjes. P.sh:
- qerpiku: si **krahu i dallëndyshes**- lëvizshmëria e qerpikut si e krahut të dallëndyshes.
  - goja: si lulja **që shpërthen**, pra në zhvillim e sipër, në rritje, në lulëzim,
  - fytyra: si molla **në degë**
  - vetulla: si fiskaja- theksohet elasticiteti, eleganca, etj.

**4 pikë**                      Nëse argumenton në mënyrë të plotë bukurinë në lëvizje të Tanushës bashkë me tri detajet më domethënëse.

**3 pikë**                      Nëse argumenton në mënyrë të plotë bukurinë e Tanushës të dhënë në lëvizje bashkë me dy detajet më domethënëse.

**OSE**

**3 pikë**                      Nëse jep vetëm tri detajet më domethënëse.

**2 pikë**                      Nëse jep një argumentim dhe një detaj.

**OSE**

**2 pikë**                      Nëse jep vetëm dy detaje domethënëse.

**1 pikë**                      Nëse jep vetëm një argumentim.

**OSE**

**1 pikë**                      Nëse jep vetëm një detaj të saktë.

**0 pikë**                      Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

*Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, përmend arsye që nuk i përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit i gjykon të sakta.*

**Pyetja 11**                      **2 pikë**

**1 pikë**                      po ta fikin: shqetësimi lidhet vetëm me Mujin. Ty po ta fikin derën.

**1 pikë**                      po na koritin: shqetësimi lidhet me gjithë fisin (përfshi edhe Mujin). Shqetësimi bëhet i përbashkët në rastin e dytë, në krahasim me vargun e mësipërm.

**0 pikë**                      Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 12**                      **1 pikë**

**1 pikë**                      Bukuria e Tanushës është aq e madhe sa për ta përshkruar duhen mbledhur shumë elementë e objekte nga më të bukurit e natyrës.

**OSE**

**1 pikë**                      Bukuria e Tanushës bëhet objekt krahasimi me bukurinë e përsosur të natyrës (me elementet më të bukura të saj); kështu bukuria njerëzore ngrihet në shkallë më të lartë.

**0 pikë**                      Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

*Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, bën një interpretim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.*

**Pyetja 13**                      **2 pikë**

- 1 pikë**                      Rapsodi është fokusuar më shumë në portretin fizik të vajzës.
- 1 pikë**                      Sepse, për mendësinë popullore, më e rëndësishme është bukuria fizike.
- 0 pikë**                      Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 14**                      **2 pikë**

- 1 pikë**                      **fonetik:** a-hundore –ë                      gja-gjë, ma-më, zanë-zënë  
**OSE**                      ue-ua: martue-martuar
- 1 pikë**                      **leksikor:** çetinat-pishat  
**OSE**                      bash-tamam
- 0 pikë**                      Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare

**PJESA II****Balzak***Evgjeni Grande (fragment)*

- Pyetja 15**                      **B**                      **1 pikë**
- Pyetja 16**                      **B**                      **1 pikë**
- Pyetja 17**                      **C**                      **1 pikë**
- Pyetja 18**                      **C**                      **1 pikë**
- Pyetja 19**                      **B**                      **1 pikë**
- Pyetja 20**                      **C**                      **1 pikë**

**Pyetja 21**                      **4 pikë****Model përgjigjeje**

- Plaku është në prag të vdekjes. Por edhe në këto çaste ai mbetet makut. As vdekja nuk e ndryshon dot. Theksohen vazhdimisht sytë e plakut dhe duart e tij. Janë të vetmet që gjallojnë në atë trup që po vdes. Është po ai njeri, me po ato vese, me po atë portret. Ka po ata sy lakmitarë, po ato duar që përpiqen të kapin dhe rrëmbejnë gjithçka, ka po atë padurim të të pasurit dhe zotëruarit.

**Ilustrime:**

- *duke kullotur sytë mbi verdhushkat,*
- *ai shtriu, i babëzitur e i llahtarshëm, dorën që ta kapë;*
- *sytë e bablokut ...u ringjallën*
- *M'i sill këtu para syve të mi!*
- *Kyçe këtë derë se mos më vjedhin!*

- 2 pikë**                      Nëse tregon qartë thelbin e portretit të Grandesë.  
**DHE**
- 1 pikë**                      Nëse shpjegon **pjesërisht** portretin e Grandesë.
- 2 pikë**                      Nëse gjen **dy** shprehje nga fragmenti që japin thelbin e portretit.  
**DHE**
- 1 pikë**                      Nëse gjen **një** shprehje nga fragmenti që jep thelbin e portretit.
- 0 pikë**                      Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

*Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, bën një interpretim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.*

**Pyetja 22****3 pikë****1 pikë**

Edhe në çastet e tij të fundit, plaku mbetet i lidhur me dashurinë e vetme të tij, parandë (para tavolinës ku shtrohet ari). Ndërkohë që Evgjenia i thotë “baba”, ai asnjëherë nuk i thotë “bijë”. Ajo i kërkon uratën, ai në mënyrë cinike e kërcënon.

**1 pikë**

Jo nuk ka ndryshuar. Grandeja është po ai që ka qenë diku, ka po atë autoritet, po atë imponim, po atë hije të rëndë.

**1 pikë**

Për Grandenë rruga për tek e bija kalon nëpërmjet parasë, prandaj qëndrimi i tij nuk ndryshon.

**0 pikë**

Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 23****2 pikë****Model përgjigjeje**

- Plakun nuk e trondit aspak vdekja. Vdekja e vërtetë për plakun Grande është ndarja nga paratë. Për Grandenë paraja është sinonimi i jetës, lumturisë njerëzore, i vdekjes.

**2 pikë**

Nëse sqaron **plotësisht** thelbin e këtij raporti.

**DHE****1 pikë**

Nëse sqaron **pjesërisht** thelbin e këtij raporti.

**0 pikë**

Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 24****4 pikë****Model përgjigjeje**

- Dramaciteti buron nga fakti se Grandeja nuk shqetësohet se po vdes, por se po ndahet nga pasuria, nuk e shqetëson vajza që po lë vetëm, por ka hallin e mallit të tij. Nuk i bën përshtypje asnjë përkujdesje. Gjithçka ndodh në një kontrast bardh e zi. Në një anë Evgjenia me përkujdesjen e saj dhe në anën tjetër Grandeja i ftohtë dhe autoritar që mendon vetëm për paratë. Kjo makutëri dhe ky pasion i pandryshuar i tij nga asgjë, kjo mungesë e ndjenjave njerëzore sjell dhe dramacitetin në këtë fragment. Ideja e autorit shfaqet nëpërmjet fjalive, gjesteve, mimikës së personazhit. Këto realizohen përmes **detajeve artistike** si: *vatër, zjarr, fytyra që shkëlqen nga drita e lumturisë, sytë e bablokut, kryqi, vazoja, shandanët, nishani, dora. fjalive pyetëse, foljeve në urdhërore etj.*

**2 pikë**

Nëse shpjegon qartë nga buron dramaciteti.

**DHE****1 pikë**

Nëse shpjegon pjesërisht nga buron dramaciteti

**2 pikë**

Nëse gjen dy detaje që shprehin këtë dramacitet.

**DHE****1 pikë**

Nëse gjen një detaj që shpreh këtë dramacitet.

**0 pikë**

Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 25**                      **8 pikë**

Për esenë do të ndiqen kriteret e mëposhtme:

**KRITERI I: SHTJELLIMI I IDESË****2 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- shkruan një ese ku argumenton se si pasioni mbizotërues bëhet shkatërrues për plakun Grande.
- shpreh qartë se si ndikon ky pasion në ndjenjat e Grandesë dhe si drejton ai jetën e tij edhe në çastet e fundit.
- i mbështet idetë e veta me shembuj nga teksti i dhënë
- përdor detaje mbështetëse
- ka qartësi mendimi

**KRITERI II: ORGANIZIMI DHE STRUKTURA E ESESË**    **2 pikë****1 pikë**                      **Struktura e esesë**

- respekton elementet e strukturës së esesë:
  - hyrjen
  - zhvillimin
  - përfundimin

Nxënësi merr **1 pikë** nëse përgjigjen e dhënë e strukturon sipas skemës së mësipërme.

*Nëse mungon njëra prej tyre, ai do të marrë 0 pikë për këtë rubrikë.*

**1 pikë**                      **Organizimi i esesë**

- organizim logjik, ku shfrytëzohen teknika të tilla si koherenca dhe unifikimi i paragrafëve (lidhja logjike mes paragrafëve, kalimi në mënyrë të natyrshme).

**KRITERI III: STILI DHE ORIGJINALITETI****2 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- Përmes gjuhës që përdor krijon një përshtypje të përgjithshme për atë që do të shprehë.
- shprehet me një gjuhë eseistike
- ka fjalor të pasur
- stil origjinal

**KRITERI IV: SAKTËSIA GJUHËSORE****2 pikë****(1 pikë sintaksa dhe 1 pikë drejtshkrimi)**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- strukturon qartë përgjigjen nga pikëpamja gramatikore
- ndërton fjali që janë të sakta dhe të qarta
- përdor fjali që variojnë në modele, gjatësi dhe ritëm
- ka saktësi drejtshkrimore